



**Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë**

**Prezenca në Shqipëri**

**FJALIMI I KRYETARIT TË PREZENCËS, AKREDITIMI I VËZHGUESVE TË NXJERRJES  
PARALELE TË REZULTATEVE, 24 QERSHOR 2009**

Ambasadori Withers, Kryetari Ristani, Drejtori Celibashi, të ftuar të tjerë të nderuar, zonja dhe zotërinj, mirëmëngjesi!

Jam i gëzuar që jam pjesë e kësaj ngjarjeje të rëndësishme këtë mëngjes për njohjen publike dhe nderimin e atyre grupeve të shoqërisë civile, që do të marrin përsipër projektin e nxjerrjes për herë të parë në mënyrë paralele të rezultateve të zgjedhjeve në Shqipëri gjatë zgjedhjeve të së dielës.

Çdo mekanizëm, çdo mjet apo veprimtari që i shërben forcimit dhe ruajtjes së një besimi më të madh të publikut Ditën e Zgjedhjeve mund të mirëpritet dhe të përqafohet.

Unë i përgëzoj gjithë ata që kanë marrë pjesë në përgatitjen e këtij projekti.

Unë besoj se gjithë njerëzit e përfshirë në të do t'i ndërmarrin detyrat e tyre me kujdesin, energjinë dhe profesionalizmin më të madh.

Veprimtaria që ju do të kryeni është e rëndësishme për zhvillimin demokratik të këtij vendi, dhe vlerësohet shumë nga komuniteti ndërkombëtar, por ajo çka është më e rëndësishmja është se ajo çmohet nga gjithë shqiptarët.

Një barrë e rëndë përgjegjësie ndoshta, por një përgjegjësi, që jam i sigurt se ju do ta ndërmerri me vendosmëri, energji dhe gjallëri.

Duke ju nderuar këtu sot, më lejoni disa momente të ndaj me ju, teksa i afrohem të dielës, thjesht disa mendime personale të miat.

Së pari, përgëzoj Kryetarin Ristani, si Kryetar i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve për punën dhe mundin e tij në përgatitjen e këtyre zgjedhjeve, si dhe për përpjekjet për ta orientuar procesin në ujëra të qetë.

Ne i vlerësojmë përpjekjet tuaja për ndërtimin e një konsensusi në vendimet tuaja dhe mezi presim të shohim që ta arrini këtë sidomos në lidhje me qendrat e votimit dhe të numërimit, ku rregullat e Kodit Zgjedhor do të duhet të respektohen në mënyrë të rreptë, teksa i afrohem gjithmonë e më shumë 28 qershorit dhe të periudhës pas tij.

Përçojini, ju lutem, stafit tuaj, sukseset që ne u urojmë të kenë gjatë përgatitjes së zgjedhjeve dhe vetë të dielës, ditës së votimit, dhe mesazhin se ne besojmë se ju, si staf, do ta kryeni punën tuaj të rëndësishme në një nivel të lartë.

Së dyti, për sa i përket Policisë së Shtetit, mezi presim t'i shohim sërish që ajo të luajë të njëjtin rol të paanshëm dhe profesional në Ditën e Zgjedhjeve, që e luajti kaq mirë në zgjedhjet për pushtetin vendor të 2007-ës.

Puna e tyre deri të dielën dhe në vetë ditën e zgjedhjeve do të jetë jashtëzakonisht e rëndësishme për ndërtimin dhe ruajtjen e besimit të publikut në procesin e zgjedhjeve.

Për 'shërbimin policor' që ajo ofron, Policia do të shihet nga njerëzit e këtij vendi si aktori që do të ndihmojë për krijimin e një klime të qetë dhe pa probleme.

Unë besoj se ajo jo vetëm që do t'i përmbushë standardet e larta që arriti rreth dy vjet më parë, por se ditën e diel Policia do ta rrisë edhe më shumë nivelin e saj të suksesit.

Së treti, për sa i përket partive politike, ato duhet të jenë të ndërgjegjshme për faktin se ato kanë një rol kyç për të luajtur për të garantuar që e diela të jetë një sukses i jashtëzakonshëm dhe që shqiptarët të mund të marrin pjesë më në fund në zgjedhje që ata i meritojnë, zgjedhje që plotësojnë standardet ndërkombëtare.

E pra, le të mos ketë më probleme, të mos ketë më justifikime, e as shfajësime për dështimet e së kaluarës.

Kësaj radhe, këto zgjedhje do të duhet të funksionojnë.

Kjo do të thotë që dialogu publik të mbetet i qetë dhe i arsyeshëm.

Mbi të gjitha, kjo do të thotë që gjithë votuesit të lejohen të shkojnë në kutinë e votimit të lirë, në mënyrë që ata të votojnë në mënyrë të fshehtë dhe të pavarur për këdo që dëshirojnë.

Cilido qoftë, burrë apo grua, fshatar apo qytetar, plak apo i ri, punonjës i sektorit privat apo atij shtetëror, çdo votues duhet të lejohet të ushtrojë të drejtën e tij apo të saj kushtetuese në përputhje me ndërgjegjen e vet, në mënyrë të fshehtë dhe pa asnjë presion të jashtëm.

E pra, le të jenë zgjedhjet e 2009-ës zgjedhjet që do të hapin një kapitull të ri në zhvillimin demokratik të këtij vendi.

Le të mos kemi më histori votimesh familjare apo episode, ku votuesit 'instruktohen' që të përdorin kamera celulare për të regjistruar votën e tyre, pasi kjo është rreptësisht e ndaluar.

E fundit, por jo më pak e rëndësishmja, do të inkurajoja gjithë qytetarët që ta shijojnë të dielën, sepse ditët e zgjedhjeve – si në shumicën e demokracive – shihen si 'festivale të demokracisë', që do të thotë: hidheni votën tuaj!

Le të mos harrojmë se zgjedhjet bëhen për popullin dhe se ato nuk janë pronë personale e partive politike.

Gjithë shqiptarët duhet të ndihen të sigurt se të dielën ata do të jenë dëshmitarë të një procesi zgjedhor të lirë dhe të ndershëm.

Çdo votë vlen, çdo votë do të numërohet dhe procesi i administrimit të zgjedhjeve do të jetë plotësisht i lirë, i hapur dhe transparent.

Ambasadori Withers, Kryetari Ristani, zonja dhe zotërinj,

Unë ndihem i sigurt se vota e popullit shqiptar ditën e dielë do të nxjerrë një qeveri të zgjedhur në mënyrë të lirë, një qeveri që do të punojë gjatë katër viteve të ardhshme për të mirën e

popullit dhe që do të punojë aktivisht për përmbushjen e ambicieve integrale të popullit shqiptar.

Dhe së fundi, do t'u bëja thirrje gjithë shqiptarëve që nuk i kanë marrë ende letërnjoftimet e tyre, të shkojnë e t'i marrin tani – është e rëndësishme – pasi pa to nuk do të mund të votoni dot të dielën!

Ju falemnderit shumë dhe ju uroj shumë sukses të gjithëve.

**Fund**

*KONTROLLO PËRKUNDREJT FJALIMIT TË MBAJTUR*